# Informacion për pacientin, për kolonoskopi me Clensia

FULL-DOSE




Emri i pacientit

Data dhe ora e ekzaminimit tuaj

**Mjeku juaj ju ka rekomanduar Clensia si preparat për zorrët për një ekzaminim të ardhshëm.**

Një paketë Clensia përmban 4 bustina të mëdha dhe 4 të vogla. Aroma e limonit të gjelbër e Clensia e bën të këndshëm përdorimin e saj. Ju lutemi të ndiqni këto udhëzime për t'u siguruar që t'ju pastrohen mirë zorrët dhe ekzaminimi të kryhet pa vështirësi.

**Të paktën 3 ditë përpara ekzaminimit kaloni në dietë me lloje ushqimesh me nivel të ulët fibrash, si më poshtë:**

- Biskota të thata ose peksimadhe (jo integrale) me gjalpë ose margarinë.
- Xhel, mjaltë ose reçel (pa bërthama).
- Mish pa dhjamë (mish lope, filetë derri, pulë, mish viçi, lepur, gjoks gjeldeti, proshutë e zier), peshk ose vezë.
- Oriz, makarona (jo integrale) ose kuskus me gjalpë ose margarinë.
- Supë (vetëm supë me lëng mishi dhe perime).
- Ujë, kafe (pa qumësht apo ajkë) ose çaj me sheqer.

**Shënim:** Jo sallata, bishtajore, fruta (përveç bananeve) ose perime (përveç karotave të qëruara dhe të ziera)

Data/vula e mjekut

Nëse keni ndonjë pyetje për rreziqet dhe efektet anësore, ju lutemi të lexoni fletushkën e paketimit dhe të konsultoheni me mjekun ose farmacistin tuaj.

# Përgatitja dhe përdorimi i Clensia

## Si ta përgatisni Clensia

1l = solucioni Clensia ½l = lëng i kthjellët

### Doza e parë




### Doza e dytë




- Tretni **2 bustina të mëdha** dhe **2 bustina të vogla** në 1 l ujë.
- Përgatisni **të paktën ½ l** lëng të kthjellët, si p.sh. ujë ose çaj (pa qumësht) për **çdo dozë solucioni 1 l Clensia.**

## Si ta përdorni Clensia

**Mos konsumoni ushqime të ngurta pasi të keni filluar përdorimin e Clensia.**

**Mos pini asgjë për 2 orë përpara ekzaminimit.**




- Pini **250 ml solucion Clensia** çdo 15 deri në **20 minuta.**
- **Pas çdo litri solucioni Clensia, pini dhe ½ l lëng të kthjellët.**
- **NUK duhet të pini asnjë lëng** (duke përfshirë preparatet për lavazhin e zorrëve) për 2 orë përpara kolonoskopisë.

FULL-DOSE

CLN1FLYI0322al


Me mbështjetjen e:
Alfasigma Schweiz AG | Luzernerstrasse 2 | CH-4800 Zofingen

ALFASIGMA